



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER XHOANA OMARI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. MINE PEZA, GODINA NR.
1, APARTAMENTI NR. 1
TEL: 0682055130

VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 796

Tirane më 14/02/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024053810042689900

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER XHOANA OMARI**



V2024053810042689900

**DATE 14/02/2024
NR REP 796**

VËRTETIM NËNSHKRIMI NE AKT THEMELIMI

Sot, më datë 14/02/2024 , para meje Notere XHOANA OMARI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. MINE PEZA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR. 1, u paraqit personalisht:


NËNSHKRUES/IT:

Jonada Kau, atësia Shyqyri, amësia Hazbije, shtetas Shqiptar, lindur në Grabovëp, Gramsh dhe banues në KRUIJË, me adresë Ledinge 00840042; Nd. 1; H. 1; Krujë; Krujë; 1501; Krujë, lindur më 03/05/1990, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033561996 dhe nr. personal J05503082G , .

Subjekti i mësipërm , në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, “Akt Themelimi te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " GEA SHOES" SHPK”, te bashkëlidhur dhe une Noterja i vertetova nenshkrimin .

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



AKT THEMELIMI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GEA SHOES" Shpk

Sot më datë 14.02.2024, si themelues me të dhënat e mëposhtme:

- Znj. JONADA KAU lindur ne GRAMSH, SHQIPERI me 03/05/1990, banuese ne KRUJE,SHQIPERI ME ID J05503082G.

ka vendosur te nënshkuaje Aktin e Themelimit te mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës regullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

Neni 1- Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "GEA SHOES" Shpk

Neni 2- Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Rr. Hamdi Ferhati, Ndertese 1 Kateshe me Nr. pasurie 558/1/ND, zk 3426, Tirane. , Shqipëri.
- 2.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do te bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.
- 2.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Neni 3- Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e papërcaktuar.

Neni 4- Objekti i Shoqërisë

2.1 Qepje faqe kepucesh, Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial, lëkur, tekstile dhe prodhime të tyre. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë, këpucësh, faqe këpucësh, për llogari të vet dhe për të tretë. Tregtimi dhe përpunimi I veshjeve



dhe rrobave të punës, për vete dhe për të tretë (fasoneri), si dhe blerje - shitje të makinerive të përpunimit e prodhimit të lëkurës, pëlhurës dhe të tekstileve. Transport brenda vendit dhe ndërkombëtar për vete dhe të tretë. Prerje, qepje e prodhim të këpucëve, çantave, rrypave apo veshjeve të lëkurës. Tregëti me shumicë dhe me pakicë edhe on-line, prodhimin, importimin dhe eksportimin, shpërndarjen me dhe/ose pa magazinë, si kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të perfaqësisë me dhe/ose pa magazinë, të artikujve ushqimore, të veshmbathjeve të çfarëdo lloj përbërje dhe vlere, përfshirë bluze dhe këmisherë të jashtme, aksesore për veshje të çfarëdo lloj materiali, këpucë, veshmbathje lëkure, copa të çfarëdo lloj materiali,

Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar është 100,000 (njëqindmije) lekë.

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (nje) kuote, e gjitha e nënshkruar dhe për tu shlyer, me vlerë nominale 100,000 (njëqind mije) lekë.

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë :

- Znj. JONADA KAU, ofron një kontribut në para të barabartë me 100,000 (njëqindmije) lekë.

6.2 Sipas kontributeve të mësipërme :

- Znj. JONADA KAU i përket 1(një) kuotë, që i korrespondon 100% (njëqind) të kapitalit të Shoqërisë

Neni 7 – Transferimi i kuotave

7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

7.2 Në rastin e transferimit të cdo lloj titulli, qoftë kundrejt një pagese apo jo në kuptimin më të gjerë të fjalës, pra duke përfshirë dhurimin e aksioneve dhe personave të tjerë të ndryshëm nga ortakët, aksionet duhet të ofrohen me refuzimin e parë të Ortakëve të tjerë.

7.3 Në këtë rast ortaku shitës duhet tju komunikojë me shkrim ortakëve të tjerë, me anë të një letre rekomanduese a/r ku të shprehet qartë, vullneti për të shitur aksionet, kushtet e shitjes përfshirë emrin e blerësit, emrin e shitësit, cmimin e



shitjes. E drejta e parablerjes duhet ti referohet gjithsesi të gjitha kuotave të ofruara për shitje.

- 7.4 Anëtarët do të kenë 30 (tridhjetë) ditë kohë nga marrja e letrës a / r për të informuar aksionarin shitës për gatishmërinë e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Në rast të skadencës së afatit kohor, e drejta e parablerjes në favor të tyre do të bie poshtë.
- 7.5 Në rastin kur oferta pranohet nga shumica e Ortakëve, aksionet e shitura nga aksioneri ndahen në mënyrë proporcionale në bazë të aksioneve që zoterojnë secili prej tyre (pala blerese), nese nuk bëhet një marrëveshje ndryshe ndërmjet palëve. Në asnjë rast ofruesi nuk do të pranojë një ushtrim pjesor të së drejtës së parablerjes.
- 7.6 Në rast të dështimit për të ushtruar të drejtën e parablerjes, aksionet mund të transferohen drejt palëve të treta në tërësi ose në pjesë.
- 7.7 Njësitë mund të transferohen me anë të trashëgimisë në raste fatkeqësie.

Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Shoqëria administrohet gjithashtu dhe nga një Administrator i cili qëndron në detyrë deri në shkarkimin ose dorëheqjen e tij, ose për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet.
- 8.2 Përfaqësimi ligjor i shoqërisë do ti ngarkohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat në përputhje me dispozitat e nenit 95 të Ligjit nr. 9901 të datës 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- 8.3 Administratori mund të emerojë Prokurorë special për akte specifike ose kategori të ndryshme aktesh.
- 8.4 Adminisitrator i pare i shoqerise emerohet Znj. JONADA KAU lindur ne KRUIJE, SHQIPERI me 03/05/1990, banuese ne TIRANE ME ID J05503082G

Neni 9 – Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Znj. JONADA KAU

Jonada KAU